



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LEZHË
KËSHILLI I BASHKISË LEZHË

Nr. 4951 Prot

Lezhë, më 5 / 5 /2023

NJOFTIM

Për thirrjen e mbledhjes së radhës të Këshillit Bashkiak Lezhë

Drejtuar: Anëtarëve të Këshillit Bashkiak Lezhë

Për dijeni: Kryetarit të Bashkisë Lezhë

Për dijeni: Prefektit të Qarkut Lezhë

Bazuar në ligjin Nr. 139/2015 datë 17.12.2015 për "Vetëqeverisjen Vendore", neni 53 pika 2, pika 4, neni 56, pika 2 shkronja "a" dhe në Rregulloren e Këshillit të Bashkisë Lezhë, e miratuar me VKB nr. 54, datë 28.04.2020, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Lezhë me shkresën nr.prot. 358/1, datë 15.05.2020, njoftoj thirrjen e **mbledhjes së radhës (Maj 2023)** të Këshillit Bashkiak Lezhë, ditën e **mërkurë**, në datën **10.05.2023**, në orën **13:00**, në sallën e **Qendrës Kulturore të Fëmijëve**, me këtë

REND DITE:

1. Projekt-Vendim "Për një ndryshim në VKB nr. 13, datë 21.02.2023 "Për miratimin e kërkesës për kalimin në përgjegjësi administrimi nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale tek Bashkia Lezhë, të objektit Ish Materniteti Lezhë, pasuria me nr. 3/51, 3/52, zona kadastrale 8632"
2. Projekt-Vendim "Për përdorimin e Fondit të Kontingjencës, për mbulimin e shpenzimeve të paparashikuara në buxhetin e vitit 2023"
3. Projekt-Vendim "Për miratimin e Memorandumit të Mirëkuptimit ndërmjet Programit të kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP) dhe Bashkisë Lezhë, në kuadër të zbatimit të programit "Përmirësimi i Rezilencës së Komuniteteve"
4. Projekt-Vendim "Për miratimin e marrëveshjes së financimit ndërmjet Programit të Kombeve të Bashkuara për Zhvillim dhe Bashkisë Lezhë për ndërtimin e një stacioni të ri zjarrfikës në Bashkinë Lezhë në kuadër të projektit "Forcimi i Kapaciteteve të Shërbimit Shqiptar të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi"
5. Të ndryshme

Grafiku i mbledhjeve të komisioneve:

Nr	Komisioni	Dita	Data	Ora
1	Komisioni Juridik	E martë	09.05.2023	10:00
2	Komisioni i Urbanistikës, Programeve të Zhvillimit dhe Integritit	E martë	09.05.2023	10:30
3	Komisioni i Ekonomisë dhe Financave	E martë	09.05.2023	11:00
4	Komisioni i Arsimit, Sportit dhe Turizmit	E martë	09.05.2023	11:30

